



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 19.10.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.10.2022, të parashtruar nga Operatori N.SH.T. “VIKTORY COM”(Pjetër Qerimi B.I.), lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Ndërtimi i rrugëve në Rezinë “ , Nr. i prokurimit- 632-22-8010-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-083-521, nxjerr:

### V E N D I M

- 1. Aprovohet si pjesërishtë e bazuar** Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit N.SH.T. “VIKTORY COM”(Pjetër Qerimi B.I.), e dt.17.10.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrugëve në Rezinë “ , Nr. i prokurimit- 632-22-8010-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-083-521, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 11.10.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Anullohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 11.10.2022;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që lëndën ta kthejë në ri-vlerësim.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.17.10.2022, Operatori Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”(Pjetër Qerimi B.I.), ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: “Ndërtimi i rrugëve në Rezinë “ , Nr. i prokurimit- 632-22-8010-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-083-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 19.10.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik N.S.H.T. “VIKTORY COM”(Pjetër Qerimi B.I.), të dt.17.10.2022, Autoriteti kontraktues, konstaton se pretendimet e Operatorit në fjalë, janë pjesërisht të bazuara, prandaj vendos që lëndën ta kthejë në ri-vlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës